Vdekje fashizmit — Liri Popullit

Poštarina plaćena u gotovu
Taksa postale e pagueme

RILINDJA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

ИЗЛ... ДВА ПУТА НЕДЕЉНО: ЧЕТВРТКОМ И НЕДЕЉОМ

DEL DY HERE NE JAVE. T'EJTEN DHE TE DIELLEN

Redakcija: Prishtine
Rruga Emin Duraku Nr. 1

PAJTIMET
per 1 vit 192 din
— 6 muej 96 —
— 3 muej 48 —

Dorshkrimet nuk kthehen

Odgovorni urednik XHELADIN
Drejtori pergjegjes HANA

Vjeti IV Nr. 139 | PRISHTINE, e ejte 26 Gusht 1948 | Çmimi 2 dinarë

T'A PERFORCOJME SYÇELTIN NE LUFTE PER FORCIMIN E RRADHVE TE PARTIS

Tue e mbarue referatin e vet ne Kongresin e Peste te Partis s'one, shoku Tito u-kthye ne rezolucjonin e Byros Informative dhe ne poteren e lerbueme dhe te paprincip, e cila ne hazen e vet asht ka kunder Partis s'one dhe Vendit t'one. „Kjo — tha shoku Tito — nuk asht vetem sulm ne udheheqsin t'one te Partis. Kjo asht sulm n'unitetin e Partis s'one, kjo asht sulm ne bashkimin e popujve t'one te fituem me gjak, kjo asht thirrje per te gjithe elementat destruktiv per me e shkatrrue te gjithe ate qe e kemi ndertue deri me sot per fatin e popujve t'one; kjo asht thirrje ne luften civile ne vendin t'one, thirrje per çfarosjen e Vendit t'one". Mbassi e ka caktue lashtu drejte rolin shkatrrimtar te kesaj potere, e cila ma nuk ka kujdes as per te verteten, as per interesat jetesore te turmave t'ona punuese, as per interesat e levizjes revolucjonare proletare ne bote, shoku Tito ma ne fund e ka nxjerre ket perfundim: „...Nenkuptohet, kjo sprove e madhe do t'i nxjerre ne drite te gjithe ata ne Partin t'one, te cilet nuk i takojne kesaj Partije te farkueme, sikurse asht e jona. Keta jane disa, lekundesa dhe elementa te pashendoshe anmiq, te cilet deritash jane maskue ne Parti, sikurse jane p. sh. Zhujoviq dhe Hebrangu. Zakonisht kta ngrejne krye ne ditet ma te veshtira per Partin t'one dhe ne menyre te ndryshme sillen hapet kunder Partis tue kujtue se tash ka ardhe ora e tyne e dishrueme. Zakonisht, keta bijne pa meshire nga gjiu i revolucjonit, sepse ata jane te damshem jo vetem per Partin dhe Vendin t'one, por edhe per zhvillimin e drejte te mbatjeshem te socjalizmit pergjithsisht. Edhe ne kete gja na do te mbetemi te paperulun, konseguent, ashtu sikurse kemi mesue prej Lenjinit dhe Stalinit".

Keto fjale te shokut Tito i jane t'aferta dhe te kuptueshme çdo luftetari te farkuem te Partis, çdo antari besnik dhe te dhanun per Partin t'one te lavdishme, flamurin e te cileve nuk munden me e njollose kurrfare shpifjesh prej kahdo qe te vijne. Ne shumicen e madhe te vetes, antaret e Partis s'one ia kane afrue Partis ne kohen kur asht dashte me qene i gatshem per me dhane çdo gja dhe me e flijue vetveten, ne periudhen e luftes ilegale, kur ne burgjet e policis kane vdeke prej mundimit ose jane dergje, dhe ne periudhen e kryengritjes, kur asht dashte me vdeke per Partin dhe per popullin e vet. Keto kushte te luftes per jete dhe vdekje, antaret e Partis s'one, tue i krye detyret luftarake te cilat ju ka besue Partija, kane ndeshe jo vetem ne rastet e agjentave t'anmikut te perbetuem te hjedhun ne levizjen revolucjonare te puntorve para luftes ose ne brigadat t'ona per kohen e luftes, por edhe ne shembuj te lekundesave, karjeristave, t'elementave te huej dhe te njerzve te ndryshem te ligj, te cilet nuk munden me i durue veshtirsit dhe te cilet ne sulmet e veshtira perulen, e humbin moralin e luftarit, dezertojne nga lufta ose perfundojne si trathtar te Partis se vet, te klases se vet dhe te popullit te vet. Antaret e Partis s'one, te farkuem ne luften e veshtire, te mesuem me shique me guxim ne sy te çdo veshtirsije, t'edukuem prej Partis qe pa u turbullue dhe pa u lekunde te qendrojne forte ne pozitat e Partis, jane mesue me u kacafite me veshtirsit ma te mdhaja dhe me i munde, te frymzuem ne dhanjen pakufi ndaj Partis dhe popullit, te nenshtruem me koshjence diciplines se hekurt te Partis se vet revolucjonare, i kuptojne mire fjalet e permenduna te shokut Tito. I kuptojne, sepse ne to e njofin lehte te verteten revolucjonaree, te cilen e dijne nga eksperijenca e vet, sikurse e dijne nga eksperijenca e levizjes nderkombetare revolucjonare te puntorve, e veçanrisht nga historija e Partis Bolshevike, e cila permban elementa kaq te randesishem t'edukimit te vet komunist. Ata e dijne vleften e bashkimit te radheve te Partis, ata e dijne vleften e spastrimit te Partis prej elementave oportunista dhe anmiqve te mshefun, prej elementave karjerista dhe lekundesa. Ata e dijne se Partija perforcohet me kete spastrim dhe munde me fitue vetem ne qofte se lufton pa pushim dhe ne menyre konseguente per mjanimin e ketyne elementave nga radhet e tyne.

Periudha e mbasluftes, periudha e rindertimit dhe e ndertimit te socjalizmit ka sjelle detyra dhe veshtirsina te reja. Me te vertete, keto jane veshtiresit e dores se dyte, veshtirsi te ngritjes, veshtirsi te zhvillimit dhe te perparimit, veshtirsi te pashmangeshme ne rrugen e nderti mit te shoqnis socjaliste dhe veçanrisht te madhe ne vjetet e para te ndertimit socjalist, kur duhet me e perballue rezistencen e elementave te rrenes kapitalista dhe anmiqve te jashtem, por edhe rezistencen elastike te mbrapambetjes teknike t'ekonomis. Por, edhe keto veshtirsina nuk mundet me i durue çdokush, lekundesat dhe karjeristat e humbin frymen para ketyne veshtirsive. Edukimi i palodhshem i antarve te Partis dhe i te gjithe njerzve punuesa i ka shpetue shum lekundesa dhe i ka riedukue si luftare te forte, por ndonjenin veshtirsit e mundit dhe e shkatrrojne, e nxjerrin nga rradha e luftarve, e bajne si anmik.

Veshtirsinat qe i sjelle me vedi realizimi i detyrave te Planit t'one te pare Pesvjeçar jane tregue qysh ne fillim kur u-parapa Plani pesvjeçar, si dhe ma vone e deritash gjate gjithe kohes se realizimit te tij. Duhet vetem me u-kujtue se si shoku Tito i ka tregue, ne fjalimin e vet n'Asamblen, me rastin e shqyrtimit te projekt ligjit mbi planin pesvjeçar, veshtirsinat e ndryshme qe na presin me rastin e realizimit te tij. Tue folе rreth ketyne veshtirsive, shoku Tito i ka thane atehere edhe keto fjale:

„Asht e randesishme lufta kundra çdo shpirte-vogelsije dhe ngurrimi ndaj veshtirsinave te ndryshme. Kundra tyne jo vetem qe asht e nevojshme vigjilanca ma e madhe, por edhe rigoriziteti ma i madh, ne qofte se çfaqet."

Ma vone jane vue ne dukje veçanerisht veshtiresite e ketij vjetit te dyte te zbatimit te Planit pesvjeçar, te vjetit t'investimeve ma te mdhaja dhe te perpjekjeve ma te mdhaja punuese te Planit t'one. Keto veshtiresi te ndryshme i edukojne dhe i çelnikosin luftetaret e Planit i ngrejne turmat e puntorve deri ke heroizmi punues, e veçanerisht klasen puntore si ndertuesin udheheqes te shoqnis socjaliste.

Por, ky vjeti i dyte i Planit t'one pesvjeçar ka sjelle, perveç veshtersinave ekonomike dhe ashpersimit te domosdoshem te luftes se klases edhe veshtiresina te tjera te mdhaja, qe nuk jane parapa dhe te cilat ne te vertete nuk kane mujte me u-parapa. Akcjoni kundra Partis s'one dhe udheheqesis se saje, qe e ka gjete shprehjen e vet ne rezolucjonin e Byros Informative dhe fushaten shpifese te pafre nga ana e tyne, prej te cilve ka mujte me u-prite vetem ndihma ma e madhe shoqnore dhe vllaznore, ka ardhe ne fillim te ketij vjeti ma te veshtire te Planit pesvjeçar per t'i zmadhue veshtiresinat qe doemos egzistojne. Partija e jone u-tregue para ketyne sulmeve se nuk asht prej letre. Se ajo asht e fuqishme per kah kompaktesija e antareve te vet, per kah lidhshmenija e pashkeputun t'antareve dhe t'udheheqesinave te Partis dhe te turmave punuese, per kah uniteti i Frontit popullor, se asht e fuqishme ne besimin e patundun si ka shkue deri tash dhe shkon rruges se drejte te nji partije te ndershme proletare revolucjonare, e cila din me iu perballue te gjitha pengesave dhe te gjitha veshtiresinavet ne rrugen e ndertimit t'atdheut te vet socjalist. Uniteti i hekurt i Partis dhe lidhja e saje e thelle me turmat punuese jane tregue si ne pregaitjet e Kongresit, ashtu edhe gjate Kongresit, i cili iu dha pergjegjen e meritueme te gjithe atyne qe ndoshta e kane prite nji kaos ne Partin t'one.

Por, per nji numer te vogel elementash jo te shendoshe, te lekundeshem, karjerista dhe anmiqe te mshefun ne Partin t'one, ky grusht ka qene nji sprove teper e madhe, te cilen nuk muejten me e mbajte dhe e cila po i nxjerre ne shesh. Keshtu asht edhe e drejte. Partija keshtu forcohet, per shkak se pastrohet nga elementat e ketille. Disa prej ketyne çfaqen haptazi kundra Partis, te tjeret i kushtohen punes se pershperitjeve te mbrapaskenes dhe te mbjelljes s'errshme te mosbesimit n'udheheqesi, ne Parti ne ndertimin e socjalizmit; disa sharrojne aq thelle sa, te dehun nga potera kundra Partis t'one dhe Vendit t'one, transformohen perjashta ne njerez te shpergulun, disa dezertojne edhe bahen trathtar te hapet te Partis dhe te Vendit. Ne qofte se e shiqojme origjinen dhe historin e tyne te Partis, te ketyne pak ligaçave, nuk asht veshtire me e kuptue kercimin e tyne te pamend nga sferja e revolucionit t'one, humbjen e tyne te çdo perspektive, dhe as nji rast i kesaj trathtije kundra Partis dhe Vendit te vet nuk mbetet i erret dhe i pasjeguem. Te gjithe keta jane elementa te huej, jo te shendosh, me te cilet Partija ka voejte gjithmone

I keshillojme ata perjashta, te cilet sot botojne me germa te mdhaja deklarata te ndyeta e trathtare te dezertuesve te ketille nga fronti i ndertimit te socjalizmit, qe te shikojne vetem pak ne biografit e Partis te ketyne njerezve e keshtu do te ftohet shpejte entuzjazmi i tyne ... me „aleatet" e ketille. Ne qofte se do te dojshin me qene sado pak objektiv ata doemos do te bindeshin ne baze te ketyne biografive se sulmi i padrejte kundra Partis s'one ne realitet ka ngjalle ne ... antipartije gjithnji ka qene jo e shendosh dhe e paqendru-

(vazhdon ne faqen e dyte)

Plotsimi i planit te blemjes se mishit - kusht per furnizimin ma te mire te njerzve punuesa

Plani i blemjes se mishit ne Krahinen t'one asht krye ne pergjithsi me sukses deri ne mbarim te muejit korrik te k. v. Suksesi i korrun ne perjudhen e permendun i dedikohet ma teper angazhimit ma te madh te drejtorinave te blemjes, bashkimeve kooperative te rretheve dhe organizatave masovike.

Tue qene se deri ne fillim te gushtit jane korre suksese te mira dhe se organet perkatese te blemjes jane pajise me nji eksperijence persa i perket blemjes se detyrueshme te mishit, pritej me siguri qe edhe ne t'ardhme te korreshin suksese ne kete fushe veprimi. Mirepo, tue i analizue rezultatet e mbrrijtuna gja te muejit gusht, do te shofim nji gja te kundert. Nga keto rezultate shifet se shumica e rretheve nuk e plotson planin as me 50%. Ky mos-suksesi i deritashem persa i perket plotsimit te planit te blemjes se mishit rrjedhe ma teper nga se organet perkatese e kane lane kete pune pothuejse mbasdore, tue e lane me u-zhvillue prej vet-vedi. Ne vend qe, edhe tue fillue nga korriku e kendej, te punohej me plan dhe te vazhdohej lufta e nevojshme per plotsimin e planit te parapame, kjo detyre e blemjes se mishit u-la si detyre e dores se dyte, apo te trete dhe nuk angazhohet kurrkush posaçerisht per kete ceshtje. Natyrisht, keshillat popullore dhe organet e ngarkueme me keto pune justifikohen me pune te tjera te shumta si p. sh. me blemjen e drithnave, kontraktimet, ndertimin e shtepijave kooperative etj. Asht e vertete se keto probleme jane me randesi dhe kerkojne perpjekje te mdhaja dhe pune, por edhe problemi i blemjes se mishit nuk asht ma me pak randesi kur te merret parasyshe furnizimi i puntoris dhe i popullsis punuese ne pergjithesi. Prandaj, te gjitha keto probleme duhet me i zgjidhe paralelisht, tue ia dhane sejcilit randesin e duhun dhe tue u-perpjeke per zgjidhjen e sejcilit ne kohen e caktueme, mbassi nga realizimi i ketij plani mvaret edhe realizimi i planeve t'ona te tjera.

Bashke me luften per realizimin e planit te parapame asht e domosdoshme qe te bahet nji lufte e vazhdueshme per kualitetin e mishit te bleme mbasi asht konstatue se ne shumicen e rretheve mishi asht i dobet. Nga kjo damtohet si vete katundari, sepse tue e dorzue mishin e dobet perqindja e zbritjes i shtohet, e n'anen tjeter edhe pagubet ma pak; ashtu damtohet edhe vete fondi i mishit, mbassi ne vend qe me e pre nji gja te majme duhet me i pre dy te liga dhe prap se prap nuk mbrrihet efekti i duhun, ne furnizimin e mire te popullsis s'one punuese.

Gjithashtu asht konstatue deri tash se ne shumicen e rretheve plotsohet ma teper plani i blemjes se gjave t'imta se sa i gjave te trasha. P. sh. ne rrethin e Mitrovices, ku plani i gjave t'ima asht plotsue me 22%. Kjo asht nji e mete, sepse edhe kjo e damton fondin e pergjithshem te bagtis, mbasi ne vend qe te pritet nji gja e trashe duhet te priten disa copa gja t'ima per me e plotsue basin e duhun te mishit. Kurse asht n'interesin e vet katundarve qe te dorzojne ma teper gja te trasha e bile aso qe jane plake ose qe jane jashte perdorimit per pune.

Plani i blemjes se mishit ma se miri asht realizue ne muejin gusht, ne rrethin e Istokut ku asht plotsue plani i gjave te trasha me 130% e gjave t'ima 50%, mandej i Pejes me 93% per gja te trasha e 96% per gja t'ima. Ma se dobti realizohet plani ne rrethin e Ferizajt, ku as njihere deri tash nuk asht realizue plani ne rrethin e Ferizajt, ku asht plotsue vetem me 4,9% rrethi i Rahovecit me 8%, i Suharekes me 9%, i Gilanit me 14%. Ne rrethin e Prishtines asht realizue plani me 14% per gja te trasha dhe 81% i gjave t'ima, ne rrethin e Prizrenit me 9% etj.

Tue i analizue rezultatet e deritash me ne blemjen e mishit, mund te konstatohet se ne te shumten mungon kontrolli rreth realizimit te planit te blemjes se mishit, gjithashtu mungon agjitacjoni dhe ndihma e organizatave masovike, te cilat jane te thirrne qe t'angazhohen ma teper edhe per realizimin e ketij plani te randesishem.

Prandaj asht e nevojshme qe organet e pushtetit te kujdesohen dhe te perpiqen ma shum per plotsimin e planit si kualitativisht ashtu dhe ne sasi, te kujdesohen per mos-damtimin e fondit te bagtis tue luftue qe te dorzohet ma teper bagetija e majme e qe nuk perdoret as per fare as per pune.

Blemja e drithnave te bardhe

Norma e parapame per t'u realizue deri me daten 25 te k. m. asht plotsue me 59,7 per qind

Blemja e drithnave te bardhe ne Krahinen t'one tash ka fillue te zhvillohet me plan. Fshimja e drithnave, qe ishte pengesa ma e madhe per realizimin e planit te blemjes, ne shumicen e rretheve asht organizue mire dhe jane marre masa per organizimin e punes ne dy turne.

Norma e deritashme asht realizue si vijon:

Rrethi i	perqindja
Suharekes	92,6
Gilanit	78,7
Podujeves	77
Rahovecit	75
Pejes	66
Kamenices	65,7
Gjakoves	63,1
Vuçiternes	62,2
Ferizajt	59,8
Mitrovices	56,5
Prishtines	50,8
Liplanit	50
Istokut	39,3
Prizrenit	30,1
Serbices	29,8

T'a perforcojme syçeltin ne lufte per forcimin e rradhve te Partis

... edhe ne Partin t'one dhe gjithshka ka reflektue direkt ase indirekt influencen e rezistences se çirytezmesare ne Vendin t'one. Kjo asht logjike dhe e pacvilueshme, arpse çdo sulm i ketille i pakuptim dhe i podrejte kundra Partis qe e nderton socjalizmin don me thane ne piken e fundit sulm kundra vet nderlimit socjalist e prandaj base vetem ne "fuqi t'atilla te shrondosha" ne Vendin t'one, te cilat jane ne realitet ase armike ase pengoje e nderlimit socjalist. Sulmi i ketille doemos transformohet ne perkrahjen e te gjithe atyne ne Vendin t'one, qe sjellen si armiq ase te lehatshem ndaj nderlimit te socjalizmit ne Vendin t'one si dhe ndaj levizjes puntore-revolucjonare pergjithesisht.

Ket fakt dhe ket logjike te hekurt nuk e ndryshon aspak as ay skjarim i rrejshem dhe, deri ne pakce, hipokrit e farizjan te cilin dezertoresit dhe trathtaret tentojne me e dhane per punen e vet te ndyet provokatore, tue folur se punojne per nji fare „interesi ma te nalte", i cili nuk pajtohet me interesat e Vendit t'one, sic i kupton Partija e jone, udhehegsija e jone e Partis dhe e shtetit si dhe forcat t'ona te bashkuema ne Frontin popullor. Ndersa, çdo revolucjonari te nderdhem, çdo komunisti, i asht e kjarte se interesat e nji vendi, i cili nderton socjalizmin nen udhehegsin e forte te nji Partije Komuniste te kalitun ne lufte, nuk jane as nuk mund te jene ne kundershtim me interesat e levizjes proletare revolucjonare dhe levizjes demokratike ne bote, e te ndryshme nga interesat e vendeve tjera socjaliste. Prandaj edhe ai, i cili gjoja n'emen te disa interesave „te pergjithshme" dhe „ma te nalta" te famshme te levizjes revolucjonare botnore, e trathton atdheun e vet socjalist, po aq e trathton edhe çashtjen e pergjithshme te socjalizmit dhe te demokracis. Fakti qe elementat e tille, ne veshtersit e sotshme dhe nen grushtet e ketilla, dezertojne ne drejtim te vendeve tjera demokratike, nuk mundet me i dhane ngjyre tjeter dezertimit dhe trathtis se tyne ndaj atdheut te vet socjalist, por me i justifikue. Sepse asht e kjarte se ata nuk i ka çue n'ate rruge kurfar ideologjije revolucjonare, por atje i ka shtye mosbesimi i tyne ne socjalizem, karjerizmi ase ambicjet e tyne personale, friga e tyne para veshtersinave te nderlimit te socjalizmit ase llogarina te tjera te ndyta. Nuk ka kurrfarë dyshimi se keta jane po ata elementa, te cilet ne nji situate tjeter, e nen grushtet qe eventualisht do te vijshin nga ana e imperjalistave te prendimit, do t'ishin gjithashtu te gatshem me kapitulue para ketyne e me kerkue ne prendim pasaportin e njerezve te shperngulun, me u a shite vendin e tyne imperjalistave te prendimit. Dezertuesi me moral te humbun nuk pyet dhe nuk zgjedhe se ne çfare ane do t'a shpetoje personin e vet te humbun, ai doemos kapitulon n'ate ane nga e cila vjen veshtersija, te cilen nuk asht ne gjendje me e perballue.

Keshtu asht me te gjithe ata, te cilet, nen presjonin e fushates se pafrenueme kundra Partis s'one dhe Vendit s'one kane çue veten ne nji qendrim armiqsuer kundra Partis dhe Vendit, po keshtu asht plotesisht edhe rasti me Arso Jovanoviqin, i cili ishte nji nga ata ish oficera aktiv t'ish ushtris jugosllave, i cili ka hye ne Parti gjate luftes Nacjonal Çlirimtare, por qe [illegible] ...

... Prandaj asht e qarte se Rezolucjoni i Byros Informative dhe popera shpifse e cila u çue kundra Partis dhe Vendit t'one, mbasi tij nuk asht ne te vertete shkaku direkt i trathtis se ketyne tre oficerave. Ai ishte vetem „pretekst" i pershtatshem i cili ka i mjaftueshem t'i qese ne shesh keta tipa per te cilet nuk kishte vend ne nji Parti t'atille Komuniste te çelikosun sic asht Partija e jone. Persjoni tjeter i rande, nga çdo ane tjeter qofte po ashtu do t'i shtyn te sigurisht elementat e tille ne çdo ane tjeter.

Uniteti i Partis s'one, uniteti i masave t'ona punuese te bashkueme ne Frontin Popullor, uniteti i hekurt i luftarve dhe i kuadrit komandues t'Armates s'one te lavdishme jo vetem qe nuk do te lekundet me kete rast trathtije te rande, e cila mund te krahasohet vetem me rastin e Tuhaçevskut po vetem do te perforcohet. Tue i fitue per dhefishimin e vigjilances, rastet e ketilla do te forcojne bashkimin e tyne te pathyeshem, do t'i bindin edhe ma teper ne rrugen e drejte te Partis s'one dhe udhehegesis s'one, dhe do t'i nxisin edhe ma teper ne pastrimin e duhun e te pamshirshem te rradhave t'ona nga elementat e ngjajshem armiqe. Prandaj mesimi ma i randesishem qe mundem me nxjerre nga ky rast komunistat dhe bashke me ta, te gjith njerzit punuesa te Vendit t'one, asht bashkimi edhe ma i fugte i rradheve t'ona rreth vendimeve te Kongresit te Peste dhe udhehegesis se cilës Partija i ka dhane besim aq te plote, perforcimi i pa-ndalshem i vigjilances dhe lufta e pa-pajtueshme kundra te gjithe armiqve te hapet ase te mshefet te Partis s'one dhe atdheut t'one socjalist.

Gjykimi i xhelatve ustash ne Zagreb

Para Jeshillit te gjyqit te nalte te Republikes Popullore te Kroacis i u pet denimi grupit te xhelatve ustash, te Maçekut dhe çetnik ne krye me Bozhidar Kavranin dhe Luba Milloshin. Ata, pergjigjen jo vetem per disa krime, por edhe per krimet e pa numerta masovike qe i kane ba. Te paditunit, njikohsisht, jane pergjegjes per urdhnat e dhanuna per krimet, qe i kane krye organet e tyne dhe formacjonet e ndryshme ustashe, dhe çetnike.

Banditet e paditun, ne mes te cilve ka edhe prifta katolik, kane pre, vra, mundue dhe zhabe popullin e pafajshem — serbet, kroatet, judejt. Ata kane vjedhe, djegë, shkatrrue dhe asgjasue pasunin e popullit. Krimet e tyne gjakatare jane vertetue ne gjykimin me nji materjal faktesh t'a pa-rexueme ne praninin e te paditunve dhe proçesin e nji numerit te madh deshmitaresh. Famullitari katolik n'Ogulin, prifti Ivan Mikan, ne kohen e okupacjonit ka pague nga 10 dinare per çdo sy te nxjerrun nga krenat e serbve, kroatve dhe judejve, te cilet ia kane sjelle xhelatet ustash.

Ne kete gjykim asht tregue per te qinten here lidhja e ngushte qe ekziston ne mes te trathtarve te paguem te popujve t'one dhe te reakcjonit nderkombtar. Asht vertetue se sot te gjithe ustashet, antaret e Maçekut, drazhistat dhe ata qe kane ike, ase nuk kane dashte me u-kthye ne vend, jane mercenaret ma te thjeshte t'imperjalistave te prendimit dhe te kishes katolike.

Xhelatet, te cilet sot jane t'ulun ne banken e t'akuzuemve para gjyqit ne Zagreb, jane hedhe ne menyre ilegale ne Vendin t'one qe perseri te vazhdojne therrjen dhe vrasjen e banorve te qetshem, te cilet sot e nderiojne t'ardhmen t'one socjaliste te lumtun, qe te kryejne akcjone diverzante, qe te shkatrrojne dhe asgjasojne ate qe sot e ngrehim na me perpjekje te madha, qe te shpijunojne dhe t'u apin imperjalistave te jashtem informata mbi gjendjen e Armates s'one, mbi ngritjen e industris dhe bujqesis s'one, mbi centralet elektrike t'ona dhe mbi fabrikat e reja.

Spijunazhi i jashtem, kisha katolike dhe trathtaret e popujve t'one, te cilet kane mbrete ne boten e jashtme, i kane furnizue banditet e akuzuem qe pervec veprimtaris se spijunazhit te bajne edhe vepra sabotazhi. Por, keta mercenare te kapitalistave nderkombtare dhe t'armiqve te liris se te gjithe popujve, posa e kane kalue kufinin t'one, jane binde se prej punes se tyne nuk ka dobi. Jane binde se i gjithe populli punues i Jugoslavis se Titos sot punon dhe e nderton t'ardhmen e vet ma te mire. Antaret e bandes, e cila pergjigjet para gjyqit ne Zagreb, perfaqesojne vrasesit e popullit ne fushen e perqendrimit te Jasenovcit dhe ne fushe perqendrimet e tjera ne Vendin t'one, perfaqsojne xhelatet ustash dhe çetniket e kralit, „kryzharet" e kishes katolike, zotnit tradhtare te Maçekut dhe kapitalistat e jashtem, te cilet kane per qellim me i rubnue perseri popujt t'one.

Te pregatitun me emisjone te radjo-stacjoneve, me arme, me fotografi te Paveliqit, te Stepincit, te Maçekut dhe t'ish krajlit Pjeter, me komunikata dhe shpalije te ndryshme, xhelatet e paditun kane kalue ne grupe kufinin t'one me shprese qe do t'i perkrahe dikush. Por, posa kane kalue kufinin keta kriminela te paditun, kane ra ne duert e organeve te pushtetit popullor. Organet e Drejtoris se sigurimit shtetnuer, qe asht formue ne kohen e luftes Nacjonal-çlirimtare si mprojtes ma te dashtun te revolucjonit t'one popullor, i kane burgose kriminelat e paditun posa e kane kalue kufinin e Jugosllavis se re. Sot Drejtorija e sigurimit shtetnuer me plot te drejte mundet me qene krenare per dashunin e madhe dhe popullaritetin, te cilin e gezon ne popujt t'one, si edhe per urrejtjen dhe frigen qe e cjaqin kundrejt saje trathtaret e vendit ne vendin t'one perjashta dhe imperjalistat ne mbare boten.

Seanca e gjyqit ne Zagreb ka tregue se si duket puna kriminale e trathtarve ne boten e jashtme. Kjo seance asht kontribut me randesi kundra mahinatave imperjaliste ne Vendin t'one dhe ne vendet e demokracis popullore, si edhe ne lufte per ruajtjen e paqes ne bote.

VENDIM

Per shtimin e sasinave te bukes konsumuesve te cilet jane ne furnizimin e garantuem

Per shtimin e sasinave te bukes konsumuesve, te cilet jane ne furnizimin e garantuem.

Ne baze te nenit 4 te Rregullores per furnizimin e banorve, mbas propozimit te Ministrit te Tregtis dhe Furnizimit te RFPJ, Qeverija e RFPJ ka prue vendimin per rritjen e sasinave te bukes konsumuesve, te cilet jane ne furnizimin e garantuem.

1.

Konsumuesve te marrun ne furnizimin e garantuem, te cilet marrin ma pak se 1.000 gram buke ne dite, iu shtohen sasit ditore te bukes per 50 gram, keshtu qe sasit ditore te garantueme te bukes do te jene:

Per konsumuesat e kategoris R-1a	850 gram
Per konsumuesat e kategoris R-1b	750 gram
Per konsumuesat e kategoris R-1	700 gram
Per konsumuesat e kategoris R-2a	500 gram
Per konsumuesat e kategoris R-2	500 gram
Per konsumuesat e kategoris R-3	400 gram
Per konsumuesat e kategoris D-1	300 gram
Per konsumuesat e kategoris D-2	300 gram
Per konsumuesat e kategoris D-3	350 gram
Per konsumuesat e kategoris G-1	300 gram
Per konsumuesat e kategoris G-2	300 gram

Me kete ndryshohet pika 1 e vendimit per caktimin e artikujve dhe sasinave te cilet hyjne ne furnizimin e garantuem IV Nr. 1159 prej 10 fruer 1948 ne pikpamje te sasinave te caktueme te bukes per konsumuesat e permendun.

2.

Furnizimi i konsumuesave simbas ketij vendimi do te bahet tue fillue prej 1 gusht 1948.

Kryeministri i RFPJ dhe Ministri i Mprojtjes Popullore
Marshal'i Jugosllavis
Josip Broz-TITO

Ministri i Tregtis dhe i Furnizimeve te RFPJ
Jakov Blazhevig

—※—

Shtimi e racjonit te bukes asht bu e mundesueme, pike se pari, nga shkaku se prodhimi i drithnave vjet asht gnar, i madh se ne vitin e kalum e, prodhimi ma i madh asht si rezultat i punes se vetmohueshme dhe te perpjekjeve te katundarve t'one punonjesa, te cilet i kane kuptue drejte detyrat qe te punohet çdo pllambe toke dhe, me perdorimin e mjeteve ne teknike te rritet prodhimi i drithnave per çdo njesi te siperfaqes.

Rritja e racjonit te bukes asht ne dakord me Planin pesvjeçar, i cili parashef permirsimin e standardit te jeteses te njerzve punuesa.

Kjo mase ma e reja e Qeveris s'one popullore per permirsimin e furnizimit tregon edhe nji fakt mbi kujdesin e madh te pushtetit t'one popullor, per kondita ma te mira te jetes se puntorve. Kjo, njikohsisht do t'i ep nxitje puntorve, qe me hov edhe ma te madh te punojne per kryerjen e Planit pesvjeçar te zhvillimit ekonomik te Vendit t'one.

Me randesi asht te vrehet se rritja e racjonit te bukes te na asht ba n'ate moment kur ne shum vende t'Europes çmimet e ushqimit paraqiten ne nji menyre t'ashper dhe kur sasijat e bukes ne keto vende pakesohen.

URDHNESE

Per furnizimin e garantuem te puntorve ne minjera dhe nepunsave te cilet punojne nen toke

Ne baze te Nenit 4 te Rregullores mbi furnizimin e banorve, mbas propozimit te Ministrija te Tregtis dhe te Furnizimit te RFPJ-s, Qeverija e RFPJ-s ka prue vendimin e furnizimit te garantuem te puntorve ne minjera dhe te nepunsave, te cilet punojne nen toke.

1

Puntoret e minjerave dhe nepunsat te cilet punojne nen toke u garantohet me marr:

a) Mish 8.500 gram ne vend te 7.500 sic ka qene deritash.

b) Sheqer 1.750 gram, ne vend te 1.500 sic ka qene deritash.

c) Miell gruni 6.000 gram si shtese pervec artikujve t'ushqimit, qe hyjne ne furnizimin e garantuem.

2

Qeverija popullore e Republikes do t'ia sigurojne puntorve te minjerave dhe nepunsave qe punojne nen toke si dhe te gjithe puntorve te tjere te minjerave, furnizimin me qumesht, po von, tue caktue se me cilat sasina do te furnizohen me keta artikuj puntoret e minjerave.

Ne baze te kesaj urdhnese kane te drejte me u-furnizue puntoret qe punojne ne minjerat me randesi te pergjithshme dhe republikane.

IV.

Drejtorat dhe nepunsat tjere pergjegjesa te ndermarrjeve te minjerave, me fajin e te cilve, organet e tregtis dhe te furnizimit nuk do t'i marrin me kohe kerkesat e sasinave te duhuna, ase ne qofte se per shkak te ndonji gabimi tjeter, puntoret e minjerave nuk do t'i marrin me kohe sasinat e artikujve te caktuem me ket urdhnese si dhe me ato tjerat te furnizimit te garantuem, do te denohen me denim ne te holla ne 10.000 dinare.

Veprimtarin administrative rreth denimit do t'a baje dhe denimet do t'i bajn Ministri i minjerave te RFPJ-s, ase Ministri i Republikes Popullore i cili asht ngarkue me punet e minjerave.

Kryeministri i RFPJ-s dhe
Ministri i Mprojtjes Popullore
Marshal'i Jugosllavis
Josip Broz — Tito

Ministri i Tregtis dhe i
Furnizimeve te RFPJ-s
Jakov Bllazheviq

Komunikate e Ministris se Financave te RFPJ mbi perqindjet e tatimit mbi t' ardhunat e puntorve dhe nepunesave

Ne Belorten zyrtare te RFPJ nr. 71 date 21 te k. m. asht botue Dekreti i Qeveris se RFPJ mbi tatimin mbi t'ardhunat e puntorve dhe nepunsave. Dekreti dhe Vendimi kane hy ne fuqi nga dita e botimit, keshtu qe tue fillue nga data 1 shtatuer e ketij vjeti, tatimet mbi t'ardhunat, meditjet dhe rrogat do te llogariten simbas perqindjeve te parapame ne kete Vendim.

Tue qene se dispozitat mbi perqindjet e tatimit do t'aplikohen mbi te gjitha meditjet dhe rrogat, tue fillue nga data nji shtatuer te ketij vjeti, u-derhiqet vrejtja te gjitha ndermarrjeve, institucjeve dhe zyreve si dhe te tjerevet, qe te kene kete fakt para syshe dhe ne listat e veta te rrogave per muejin shtatuer t'a llogarisin tatimin mbi t'ardhunat e puntorve dhe nepunsave simbas perqindjeve te parapame ne vendimin e nalte permendun.

Me rastin e llogaritjes se tatimit per baze do te merret rroga bruto nga nji marredhanje pune me te gjitha shtesat, me perjashtim te shtesave te perhershme personale, shtesave te funksjonit, te shperblimit dhe t'ardhunave eventuale. Shtesave te permenduna me ia caktue tatimin veçmas per sejcilen veç e veç, kurse te gjitha te marrunat tjera mbledhen dhe u-caktohet tatimi bashkarisht. (Art. 8 i Dekretit).

Persa i perket caktimit te tatimit te puntorve te transportit neper fimaj dhe puntorvet ndihmesa neper shtepija, do te veprohet sikurse per puntoret tjere, keshtu edhe katyne ne t'ardhunen do t'u bahet ndalimi i tatimit simbas shkalles perkatese te tatimit e ne te njajten menyre si per puntoret tjere. T'ardhunat ne natyre te puntorve ndihmesa neper shtepija nuk ngarkohen me tatim (Art. 9 i Dekretit.)

Me rastin e llogaritjes se tatimit mbi t'ardhunat e nepunsave shtetnore nuk do te ngarkohen me tatime shtesat veç e veç, t'aprovueme me rastin e gradimit, porse edhe ketyne do t'u merret per baze e gjithe rroga e tyne me te gjitha shtesat pervec atyne te permenduna ne Art. 8 te Dekretit dhe per te cilat asht parapa caktimi i veçant'i tatimit.

(Nga Ministrija e Financave te RFPJ).

Ndertimi i shtepijave kooperative ne rrethin e Drenices

Ne te gjitha katundet, ku ka qene parapa nderlimi i shtepijave kooperative, pervec keshillit te vendit Gllogove, ne te tjerat jane ngritë themelet, e ne kooperativat e keshillave Tice, Obrije, Turiçevc jane ngrite edhe muret, diku deri ne kulm e diku deri ne dritore. Tash se fundi puna asht organizue bukur mire dhe ne keshillin e vendit Rudnik, ku jane pregatite 60.000 cope tulla dhe 10.000 cope qerpiç.

Ne gjithe rrethin deri tash jane pregatite 203.000 cope tulla dhe 25.000 qerpiç. Populli i ketij rrethi ka dhane deri tash 37.775 ore pune vullnetare dhe 5.265 dite pune me kafshe bartese.

Tue e llogarite punen vullnetare, transportin e materjalin, ndihmen ne te holla prej 1.000.000 dinarsh dhe 175 metra kubik te landeve te ndertimit, e gjithe shuma mbrrihet deri tash ne 2.110.000 dinaresh.

Po t'angazhohen organizatat e Frontit edhe ma fort n'organizimin ma te mire te punes, sigurisht, do te korren rezultate ma te mira.

P. V.

Nji vizite ne Stacjonin e bleteve e te shpendeve ne Deçan

Tue u-ngjitë prej rrugës kryesore te Deçanit, e cila lidhe Pejen me Gjakoven — kah sanatoriumi — ne krahun e djathtë, disa qinda metra larg hotelit — asht i vendosun stacjoni i bleteve dhe i shpendve ne Deçan.

Drejtori i derdhshem i ketij stacjoni, Ise Vukalloviq, duket i perpiket ne detyren e tij, te cilen ai e ka krye ma se mirë prej fillimit te vjetit 1947 e deri sod.

Bashke me te u-drejtuem kah vendi i instalimit te zgjojeve te bletve.

— Kete kemi tri modele kryesore te zgjojeve te bletve — thote Iloja. Nder keto ma te preferueshmet dhe ma te mirat jane dy.

— Po ka asht qellimi kryesor — e pyes ate — a me shtue sa ma shum bletë apo me pasë ma pak e ma te mira?

— Qellimi asht qe ne stacjon te kemi modele zgjoje bletesh dhe bletë te mira e sa ma puntore — perqjegjet ai, ne menyre qe prej modelve qe kemi na te mesohen katundaret t'one e qytetaret per me i rritë ma ne kushte sa ma te mira, e mos te zgjajie qe tue e ierhjeke mjaftë ma, shum prej tyne te mbysin me qinda mizë bletesh.

Tue i vizitue zgjojet nji nga nji e model per model, Iloja thote se nder qellimet kryesore t'ona asht qe modelet moderne te zgjojeve te perhapen ne nji perqindje te madhe mbrenda Planit pesvjeçar ne Krahinen t'one.

— Po deri tash a jane interesue katundaret per stacjonin e bletve.

— Po bukur mire, e prej mjafte rrethesh, e ma teper prej katundeve te rrethit te Gjakoves. Katundaret dhe qytetaret qe merren me rritjen e bletve, kur kane ardhe te na, pyetshin imtesisht per to, dhe si perfundim i vizitës se tyne asht qe nji pjesë e mirë e tyne sot i kane zgjojet simbas dy modelevet t'ona kryesore.

— Si na, ashtu dhe katundaret, ne fillim, te gjitha bletet i kemi pasë ne zgjoje primitive e periodikisht i kemi vendose nder keto modernet — thot ai. Mjalti i bletve t'ona dallohet prej te gjithë te tjerve, mbassi ne rejonin t'one ka mjafte bagrema, keshtenja, lule fiesshesh dhe terfoje te posaçme per to, te cilen e kemi mbjellë na vete ne nji pjesë te sipërfaqes se tokes, afer stacjonit t'onë. Ky mjaltë asht mjafte i ushqyeshem dhe i dobishem per t'infektuemit nga tuberkulozi. Si i tillë kerkohet bukur fort.

— E, per te muejte qe t'afrohen edhe bletet tjera-thote Iloja, do te vendosim stacjone te vogla nder kodra, keshtu qe shtohet edhe ma periferija e zonës se kullotjes per to.

— Persa i perket shpendve, thom ai, kot kemi 80 pula te mira, 430 zogj, 30 gjela, 16 bibe e 14 pata. Deri ne vitin 1951 kemi marre persiper qe te gjitha keto do t'i shtojme ne 7500 cope. Per çeljen e zogjve do te na ndihmojne mjaft 2 inkubatoret, te cilet mbrenda ketij vjeti kane kapacitet me çele deri ne 1200 zogj.

Tue e çmue randesin e ketij stacjoni, Ministrija e Bujqesis ka pasë hape qysh ne muejin e kaluem nji kurs, ne te cilin kane marre pjesë 70 te rij e te reja nga Krahina e jone, kurs i cili ka zgjatë plot nji muej. Ate e ka drejtue dhe si mesimdhanes shoku Jefiiq, i derguemi'i posaçem i Ministris se Bujqesis se Serbis. Kursistat kane perfitue mjaft, dhe dishrohet qe keso kursesh te mbahen bukur shpesh.

V. K. D.

Sulmuesa, racjonalizator dhe te lavduem ne sipermarrjen ndertimore „Sitnica"

Mitrovice:

Ne sipermarrjen ndertimore „Sitnice" ne Mitrovice me 19 te ketij muaji asht mbajte konferenca solemne e te gjithe puntorve dhe nepunsave, ne te cilen janë shpalle 34 sulmuesa, te cilet i kane tejkalue normat prej 22 deri ne 46%. Keshtu muratori Stojanoviq Stanisha e ka tejkalue normen per 30%, Maksimoviq Sima per 38% Beljulloviq Hashim per 25% e Diniq Stanisha per 22%. Hajrulla Rexhepi ne bajtjen e materjalit ndertimuer e ka tejkalue normen per 48%. Ne konferencë asht shpallë si racjonalizator Petar Sergijev, i cili me nji menyre origjinale i ka fute ne perdorim tepricat e drrasave per shtruemjen e panishtëve dhe vendeve te tjera. Prej puntorve dhe nepunsave te lavduem edhe te shperblyem, sulmuesit ma te mira ne pune i kane mberijte shoferi Ferat Jusufi, shef'i seksjonit te materja'it Borisha Rantiq, udhëheqje-i punes Mile Vukeviq dhe grupi i Sinvri Mëqeviqit, i cili ka punue ne lakimin e hekurit.

Sulmuesat, racjonalizatoret dhe te lavduemit i pershendeti sekretari i Komitetit te Vendit Lakiq Simonoviq dhe perfaqsuesi i Keshillit Krahinuer Sindikal Millan Svetniq, te cilet folen mbi randesin e luftes per ndertimin socjalist ne Vendin t'one dhe rolin, te cilin e luen klasa e jone puntore ne kete lufte.

Fiskultura dhe Sporti

Rezultatet e foot-ballit te zones se V-te

„Borac" - „Metohija" 2:1

Ferizaj:

Kete te djele, me 22 te k.m., u-zhvillue ndeshja ne fushen sportive te Ferizajt ndermjet te skuadres "Borac" nga Ferizaj dhe "Metohija" nga Prizreni.

Loja ka qene e ashper, keshtu qe referi e ka nxjerrë nga nji lojtar nga te dyja skuadrat: Reshat Hadrin, lojtar'i "Metohis" dhe Beqir Avnian, lojtar i skuadres "Borac". Kjo asht prove qe kryesite e ketyne shoqnive sportive nuk kane as ma te voglin kujdes per punen ideologjike te lojtarve por perpara tyne parashtrojne detyre qe me fitue me çdo kusht.

—o—

„Poleti" - „Sloga" 3:0

Mitrovice:

Simbas vendimit te Bashkimit Fiskultural Krahinuer asht anulue ndeshja ne mes te "Slogës" nga Lipjani dhe "Poletit" nga Prishtina. Mo skuadra asht dashte te ndesheshin ne terenin neutral te Mitrovices. Mbassi skuadra "Sloga" nga Lipjani nuk ka ardhe, referi ka prite 20 minuta e pastaj i ka dhane fund lojes 3:0 ne favor te skuadres „Polet", si aforfe. Ne ket menyre skuadra "Polet" nga Prishtina asht klasifikue ne gjysemfinalen per kampjonat ne zonen e V-te.

Qe te mos largohej publiku pa e pa lojen, qe ka ardhe ne nji numer te madh, asht ba ndeshja ne mes te skuadres "Polet" nga Prishtina dhe "Trepça" nga Mitrovica. Mbas nji loje jashtzakonisht te gjalle dhe te bukur, loja perfundoi 3:2 ne favor te skuadres "Trepça".

—o—

Dita fiskulturale ne Peje

Me 22 te k.m. ne fushen sportive te skuadres "Ardhmenija" ne Peje, shkolla e mesme fiskulturale e Republikes Popullore te Serbis nga Novi Sadi se bashku me "Ardhmenin" e ka mbajte diten e fiskultures.

Koha ka qene e bukur. Ne fushen sportive ishin mbledhe ma teper se 2.000 shiques.

Dita fiskulturale ka fillue me hymjen e nxanesve te shkolles se mesme fiskulturale. Ne piken e pare te programit te vet, nxanesit e shkolles se mesme fiskulturale i kane çfaqe ushtrimet e çfaquna ne Prage ne manifestimin fiskultural te XI te sokolve ne Prage. Ushtrimet kane qene te çfaquna mire dhe kane lane pershtypje te mire te shiquesit. Mbas ketij ushtrimi fillot programi gjimnastikuer i atletikes se lehte dhe sportiv. Ne garat e atletikes se lehte kane marre pjese edhe antaret e seksjonit t'atletikes se lehte te skuadres "Ardhmenija". Asht vrapue ne 100,400 dhe 1,500 metra. Ne 100 metra i pari ka mberrijte nxanesi i shkolles se mesme fiskulturale, Postajoski, per 11,6 sekonda, ne 400 metra Mirkoviqi, nxanes i shkolles se mesme fiskulturale per 60,5 sekonda dhe ne 1.5500 metra ka mbrri si i pare Popoviqi, antar'i skuadres "Ardhmenija" per 4,5,55 minuta.

Ne fund te ketij programi asht zhvillue ndeshja e foot-ballit ne mes te seksjonit te foot-ballit te shkolles se mesme fiskulturale dhe te seksjonit te foot-ballit te skuadres "Ardhmenija". Mbas lojes se gjalle nga te dyja anet, ka fitue skuadra ma e mire "Ardhmenija" me rezultat 3:1. Golat ne favor t'"Ardhmenis„ i kane shenue Babaroqiqi 2 dhe Jovanoviqi 1, kurse per shkollen e mesme fiskulturale „Pantiqi me njimbedhetshin.

Gjakove

Ne ndeshjen e footballit qe u-zhvillue ne mes te skuadrave "Partizan" e Divizjonit t'Armates ne Gjakove dhe "Vllaznija" e qytetit te Gjakoves, loja perfundoi 2:0 ne favor te se fundit.

Golin e pare e shenuen lojtaret e "Vllaznis" ne te 28-in minute.

Lojtaret e "Partizanit" e ashpersuen bukur fort lojen dhe shpesh here e rrezikuen porten e kundershtarit, por topi prap bidhet ne porten e te mundence dhe shenohet goli i dyte; keshtu qe loja perfundoi 2:0 ne favor te skuadres "Vllaznija".

Arbitri nuk qe edhe aq objektiv mbassi i kane kalue pa i pa shum gabime nga te dyja anet.

Loja ngjalli interesim ne popull, po keshtu edhe nder luftaret e Divizjonit.

Konference e Rinis se kursit t'ulte pedagogjik

Para sa ditesh u-mbajt konferenca e Rinis se kursit pedagogjik te Prishtines, te cilen e hapi sekretari i saj shoku Ramiz Rexhepi.

P i k e n e p a r e t e k e t i j rendi dite e paraqiti shoku Hazhi Qeku, antar'i sekretarjatit te rinis. Nder te tjera ai theksoi se na mesuesit e popullit duhet te bahemi te vleishem per te, sepse edukimi i brezit te ri mvaret kryesisht ke na. Ne piken e dyte e muer fjalen shoku Sherif Thaçi i cili i vuni ne dukje te metat dhe vullnetin e paket qe kane pase kursistat per mesime ne pergjithesi. "Populli pret shum prej nesh, e prandaj ai nuk kursen asgja per ne, mjaft qe te realizojme qellimet t'ona te vleshme".

Mbi rregullat e internatit flet shoku Ramiz Rexhepi, i cili thekson nevojen e perforcimit te diciplines nder te gjithe, mbajtjen e harmonis dhe shtimin e frymes se kolektivitetit pa marre parasysh ne se jemi prej katundesh a qytetesh. Per ket duhet te jemi konsjente sepse na nderamjet punes s'one duhet te ndikojme ma se shumti n'edukimin e brezit te ri me frymen internacjonaliste-perfundon ai.

Biseduen dhe shoket kursista: Abdyl Halili, Qemal Berisha, Ahmet Morina shoqeja Viktore Betoli, Çaush Delija, Filip Krasniqi dhe shoqja Koperniku.

Antaret e Frontit na shkruejne

Ne nji te dielle te kalueme, antaret e deges sindikale te keshillit popullor te vendit ne Gjakove kishin organizue nji piknik per ne katundin Rogove. Qellimi i organizimit te ketij pikniku ne fillim qe i mire, por ai humbi vleren e tij sasija e dhete kilogramve raki, te cilen e kishin ble disa, qe paskan kujtue se nuk mund t'u bahka pikniku pa ate „te shkreten". Kesaj sasije iu shtuen edhe 5 kgr. te tjere qe i sollen disa te tjere t'ardhun nga Rahoveci.

Tue marre parasysh sasin e rakis, sejcilit person t'atij grupi i takojshin nga 750 gram, por kjo s'mund te ndahej aq drejt, mbassi disa prej tyne kishin etje ma te madhe dhe, si „padashtë" u-turbulluen vete, tue i trazue edhe te gjithe shoket e grupit sindikal. Si rrjedhim i kesaj dehjeje qe se pikniku e humbi karakterin e defrimit edukativ.

Shpresohet qe keso piknikesh nuk do t'organizoje ma jo vetem grupi sindikal i keshillit te vendit te Gjakoves, por edhe asnjoj grup tjeter, por perkundrazi sao piknikesh qe te lane kujtime e pershtypje te mira nder te gjithe.

Faik Risa

Nga puna e sipermarrjes pyjore „Rugove"

Sipermarrja pyjore "Rugove" e Pejes nuk e ka plotesue planin e transportimit te landes ne gjysemvjetorin e pare, kurse planin e prerjes e ka tejkalue me 12%. Plani i transportimit nuk asht plotsue per shkak te mungeses se rrugve te pershtatshme dhe te fuqis puntore profesjonale. Mirepo, me kryemjen e rruges Kuqishte-Boge asht lehtesue mjaft puna e transportimit.

Sipermarrja asht e ndame ne dy manipulacjone. Ne çdo vend punimi punohet me vrull, mirepo, deritash nuk asht zbatue sistemi i brigadave. Evidenca nuk ka qene ne nalcsin e duhun dhe planet nuk jane perpunue. Ne kohen e fundit ka fillue te zbatohet sistemi i brigadave e, persa i perket te metave tjera, drejtorija e sipermarrjes duhet te ndërhyje sa ma pare dhe t'i mere masat e duhuna. Gjithashtu sipermarrja duhet te zhvilloje nji lufte te vazhdueshme per zbritjen e çmimit te plote te kushtimit, mbassi deri tash nuk ka ba kurrgja.

Puna e deges sindikale asht e dobet. Konferencat mbahen mjafte rralle dhe nji pakice puntoresh marrin pjese ne to. Asht e nevojshme qe udheheqesija e deges sindikale t'aktivizohet ma teper dhe t'a ndihmoje drejtorin e sipermarrjes per zgjidhjen e problemeve te ndryshme.

—o—

Ndermarrje e magazines shtetnore „Ibar"

Mitrovice:

Magazina shtetnore e rrethit „Ibar" ne Mitrovice ka ndermarre masa per me pregadite sasi te mjaftueshme drush per nxanje gjate stines se dimnit. Simbas planit te magazines se rrethit do te pregatiten 20.000m. kub dru ne pyjet e Kopaonikut. Tash ne kete pune punojne 26 puntor.

Nga Bashkimi Sovjetik

Ne kolhozat e Turkmenistanit po ndertohen centrale hidroelektrike

Burimet e pakta t'ujit ne Turkmenistan e pengojne ndertimin e centraleve elektrike te kolhozeve me anen e energjis s'ujit. Mirepo, artelet perparimtare ndertojne centrale hidroelektrike tue e çfrytezue me ket rast presjonin e ujit ne kanalet per ujitje.

Kolhozet "Zahmet" qe mbajne emnin e Lenin dhe Molotovit ne rejonin Ahshabad kane ndertue me ndihmen e entit republikan "Selektoo" nji hidrocentral. Sot asht instalue drita ne te gjitha shtepijat e kolhozjaneve dhe n'institucjonet ekonomike dhe kulturale.

Ne rejonin Kahkin te krahines Ahshabat ka fillue nga puna centrali hidroelektrik i Hivlabadit, i cili shum kolhozeve u jep drite elektrike. Artelet "Menzhinski", „Stalin", Ogpu„ dhe "Iskra", kane depozitue shum miljona rubla per ndertimin e centralit te tyne elektrik.

Po ndertohet centrali hidroelektrik ne kolhozin "Kzil Bajdak", te rejonit Stalin, gjithashtu edhe n'artelin "Trud", te rejonit Tahta-Bazar te krahines Marisko, ne kolhozet "Molda" dhe "Voroshilov" te rejonit Kahkin te krahines Ahshabad. Tete kolhoza te rejonit Geok-Tepin te krahines Ahshabad po e ndertojne centralin hidroelektrik i cili do t'u ape drite shum kolhozeve.

—o—

Filmat ne gjuhen moldave

Sipermarrja e filmave n'Odese e ka krye punen rreth filmave ne gjuhen moldave "Jeta ne Citadel" dhe "Pirogov". Keta filma çfaqen ne kinemat e katundeve te Republikes Socjaliste Sovjetike te Moldavis. Gjithashtu po pregatiten ne gjuhen moldave edhe keta filma: "Çeshtja Ruse", „Grushti i Trein", dhe per ata qe gjinden ne dete".

—o—

Punet e arstistave turkmenas

Ne kohen e fundit artistat e Turkmenis kane krye nji varg punimesh artistike.

Artisti popullor i Republikes Bjashin Nurali e ka krye portretin "Takjui", Jakub Anamurovi e ka krye portretin "ne familjen e rojes se kufirit", e Nijazi Dovodovi e ka krye portretin—"muzikantat e rij". Haki Alaberdijevi i ka pikturue disa panorama.

Artisti K. Haikin e ka krye portretin "Per atdhe!", e P. Koroljevi, e ka krye "Gemiten e fundit". Te dyja keto tregojne episode nga lufta e madhe Patriotike.

Lexoni revisten t'uej „PERPARIMI"

Ka dale nga shtypi numri i i Revistes „Perparimi" me ket permbajtje:

Deklarata e KQ te PKJ ne lidhje me Rezoluten e Byros Informative te Partive Komuniste „Mbi gjendjen ne Partin Komuniste te Jugosllavis".

Deklarata e KQ te PKJ drejtue Sesjonit te Byros Informative.

Pergjegje shokut Çervenkov e tjereve.

Gjestet aventuriste te qeveris ne Shqipni kundra interesavet jetsore te popullit te Shqipnis.

Pergjegjesija e Komunistave.

Ndertimi'i socjalizmit apo forcimi'i elementave kapitalista ne katund e qytet.

Demokraci mbrenda Partije apo «regjim terrorist-turk» ne PKJ.

Edhe nji dustrim i padrejtesis s'akuzes se Byros Informative.

Ndertim apo tradhtimi'i socjalizmit

Per krijimin e Bashkimit te shoqnive kulturo-arsimore ne Kosmet.

Visari gjuhesuer ne folkloren t'one dhe nevoja e shiqimit te saje me sy kritik.

Kronike.

Nga situata nderkombtare

Partija Komuniste e Anglis kerkon qe te ndalohet lufta barbare kundra popullit te Malajes dhe asaj t'i epet pamvaresija

Ne lidhje me tentatin e pushtetit kolonjal t'Anglis qe t'a shtyp kryengritjen e popullit te Malajes, Partija Komuniste e Anglis dha nji deklarate ne te cilen i drejtohet te gjithe popullit puntor t'Anglis qe te protestoje kundra luftes ne Malaje dhe te kerkoje qe menjiheri te ndalohet kjo lufte barbare kolonjale.

Populli i Malajes, thuhet ne deklarate, lufton per te drejtat e veta demokratike dhe per çlirimin kombtar. Ata luftojne nen te njajten udheheqje e cila i ka udheheqe ne lufte kundra pushtuesit japonez. Ata luftojne kundra regjimit te shtypjes, i cili i ka tradhtue te gjitha premtimet ne pikpamje te liris dhe te pamvaresis te dhanuna kah mbarimi i luftes.

Bombardimi i katundeve, vrasja e njerzve, grave dhe femijve, arrestimi me masa i qytetarve, ndalimi i veprimit t'organizatave demokratike dhe sindikale dhe zhdukja e te gjitha te drejtave civile, perdorimi i djemave te gjuhtarve per kokat e njerzve kundra popullit te Malajes dhe te Kines te gjitha keto perfaqsojne metodat barbare dhe terroristike qe te zhduket lufta e popujve te cilet luftojne per çlirimin e vet.

Turp asht qe "spitalerat" dhe „lufetarët" te cilat i kane ndreqe puntoret e Anglis per lufte kundra fashizmit, te perdoren per zhdukjen e bashk-puntoreve te tyne ne luften çlirimtare.

Ne Malaje grumbullohen trupa te shumta t'Anglis, pushteti ushtarak kaptazi llogarite se lufta do te vazhdoje jashtezakonisht me vjete.

A e kuptojne te gjithe puntoret e Anglis se ne barre te cilit do t'i ngarkohen vendit t'one, sa shtrenjt do t'i kushtoje popullit anglez dhe sa vuejtje do t'i bahet popullit te Malajes?

Duhet qe te sakrifikohet jeta e puntorve t'Anglis per interesat e cirit-nesve te kallajit dhe te gomes.

Sikur te kishim ne e ka ket lufte qeverija konservatore, i gjithe vendi i one do te jehonte nga protestet e levizjes puntore. Levizja puntore gjithnji ka vue ne dukje qendrimin e vet per pamvarsin e te gjithe popujve kolonjale. Detyra e shejte asht me jetue n'ansin e popullit te Malajes dhe me ba presjon ne qeveri qe te marre fund lufta, sepse ket lufte e udheheqe qeverija e cila sundon n'emen te levizjes puntore t'Anglis.

I thrasim puntoret e Anglis qe te mos pranojne me prodhue municjon dhe me transportue trupa per ne lufte kundra popullit te Malajes.

Ma ne fund, kerkohet qe te terhiqen trupat e Anglis nga Malaja, te ndalohet lufta kundra popullit te Malajes dhe t'i epet pamvarsija kesaj.

Lufta te rrebta te kryengritsave te Malajes me forcat ushtarake dhe policore t'Anglis

Kryengritsat e kane rrxue nji aeroplan t'Anglis

Simbas lajmerimit t'agjencis „Junajted-Press" 10 km. ne perendim te Kuala-Llampurit, kryeqytetit te Malajes, zhvillohen luftimet e rrepta ne mes te kryengritsave dhe te trupave te bashkueme kolonjale ushtarake dhe policore t'Anglis. Kryengritsat e kane rrxue nji avijon t'Anglis afer Batus ne shtetin Kallentan, i cili vezhgonte grumbullimin e forcave te kryengritsave.

Simbas lajmevet t'agjencis „Rajter" kryengritsat e kane thye nji kolone t'ushtarve t'Anglis ne Gjohora, e cila shkonte ne ndihme ne plantazhen e Uamburgut, afer Llojanga te cilen e kishin sulmue kryengritsat.

Tue u-perpjekë me mshefe seriozitetin e kryengritjes dhe suksesat qe korren kryengritsat, pushteti i Anglis e ka vue ne perdorim cenzuren e rrepte per te gjitha lajmerimet mbi luftat me kryengritsa. Te gjithe korrespondentat duhet patjeter te pajisen me leje te komandes t'Anglis dhe me u-veshe me uniforma te korrespondentave.

Lufta çlirimtare e popullit te Kines

Agjensija "Kina e Re" njofton se njisite e Armates Nacjonal-çlirimtare te Kines kane çlirue fortifikaten e randesishme Shihakjen ne vijen hekurudhore Pejping Congteh. Agjensija njofton mandej se njisite e Armates Nacjonal-çlirimtare Kineze kane shpartallue divizjonin 36 te Komingtangut ne veri-lindje te Sijanit. Gjithashtu asht çlirue edhe krahina Jellova Dragon-Moku dhe, keshtu u asht dhane nji goditje e forte planeve te Komintangut. Trupat Nacjonal-çlirimtare e kane pushtue dhe lazem e randesish ne Peiki. Ne veri te Hojangut njisite e Armates Nacjonal-çlirimtare kane [illegible] rezistencen e armikut dhe vazhdojne luftime te rrebta per zhdukjen e njisive te shpartallueme te trupave te Komintangut.

Agjensija "Tass" njofton:

Kater zezak te njoftun: kengetari Robson, historiku Diboa, politikani i njoftun Hauer, i cili e ka hape kongresin e Partis progresive ne Filadelfi, dhe Dangji, redaktori i fletores zezake "Blek Dispeç", e cila del ne Oklahoma Siti, i kane dergue nji porosi Trumanit dhe ministrit te drejtesis Klarkut, ne te cilen ne mes te tjerave thuhet:

"E denojme ashper krijimin e misterit dhe t'arrestimit te krenve te Partis Komuniste te SH.B.A. dhe ju ftojme qe te merrni masa pozitive per mprojtjen e te drejtave qytetare dhe ju me i shtype pakicat kombtare".

Burrat zezake te shtetit kane deklarue se ata mak i mprojne principet komuniste. "Detyra e jone asht me i mprojte te drejtat politike dhe te pakicave te tjera, veçanerisht te popullit zezak, kur luftojne per nji shoqni t'atille te cilen e konsiderojne si te domosdoshme per realizimin e plote te principit te demokracis amerikane. Pajtohemi plotesisht me deklaraten e Henri Valasit se mprojtja e te drejtave qytetare te komunistave asht vija e drejte e mprojtjes se liris se popullit demokrat. Historija e Gjermanis, Italis, Japonis, dhe Spanjes se Frankos duhet te na mesoje se shuemja e komunistave asht vetem hapi i pare drejt sulmit kundra te drejtave demokratike te puntorve, kundra pakicave kombtare dhe kundra te gjithe atyne qe e kundershtojne politiken e qeveris ne fuqi. Qellimi i kjajtë i ketij arrestimi te krenve komunista asht me e largue popullin nga levizja e Valasit dhe e organizatave perparimtare popullore, kundra te cilave ka shpife ministri i drejtesis dhe keshilli per shqyrtimin e veprimtaris anti-amerikane si "komunista dhe elementa subversive".

—o—

ROME:

Korrespondenti i "Tanjugut" lajmeron:

Para disa dite, n'Itali asht ba greva e pergjithshme e te te gjithe puntorve bujqe, ne te cilen kane marre pjese afer 3 miljone puntore. Ne greve pervec puntorve t'organizuem ne sindikate te konfederates se pergjithshme te punes n'Itali kane marre pjese dhe puntoret e sindikatave te katolikve. Veçanerisht demonstrata te mdhaja jane ba ne provincen Apulija dhe ne qarqet e tjera t'Italis se Jugut, ku puntoret bujqe rrnojne ne kondita ma te veshtira. Greva ka pase sukses te plote dhe ne provincen e Venetos, ku puntoret e sindikatave te katolikve jane ne shumice. Ne Genove greves se pare ne bujqi iu kane bashkue edhe puntoret e metalurgjis dhe te ndermarrjeve tjera industrijale.

LUFTA E POPULLIT GREK

Njisit' e Armates demokratike duken ne te gjitha qarqet per te cilat shtatmadhorija e Athines pohon se jane te „spastrueme"

Radjo stacjoni i Greqis se lire me misjonin e vet lajmeron qe ne Pindin e verior njisite e Armates Demokratike naten ne mes te 20 e 21 gushtit me nji sulm te papritun e kane marre nji pozite te fortifikueme te monarko-fashistave ndermjet majeve Alevica dhe Ginoca. Ne keto luftime armiku i ka lane 20 oficera dhe ushtare te vdekun dhe ma se 120 te zanun rob. Jane zane dy minohedhsa te rande, i mitraloz, 10 pushkomitrolosa dhe nji sasi e madhe e materjalit tjeter luftarak. Mbas nji pregatitjes se forte me artileri dhe minohedhsave, njisite e Armates Demokratike kane ba sulme ne pozitat e monarko-fashistave ne drejtim te Vola-Alevica. Armiku ka lane 60 te vdekun dhe te plagosun. Ne sektorin e Hamsa dhe Pirgos-Kotilis faqjet e Armates Demokratike kane ba sulme te forta. Ne sektorin e Gramosit gjithashtu nji vazhdojne luftimet, ku monarko-fashistat kane lane ma se 80 te vdekun e te plagosun.

Ne Maqedonin qendrore njisite e Armates Demokratike e kane çlirue katundin Ano-Poroia afer Serrzit dhe e kane shkatrrue garnizonin e monarko-fashistave.

Agjensija „Frans Pres" lajmeron se ne te gjitha qarqet e Greqis, per te cilat shtatmadhorija e monarko-fashistave pohon se jane te „spastrueme", perseri shihen njisite e Armates Demokratike. Njisite partizane nen komanden e kapitanit Diamandis perseri bajne operacjone ne rejonin e Naupaktia. Ne qarkun e Fokides asht ba nji sulm kundra garnizonit te monarko-fashistave ne qytetin Delfi, derisa ne Thesali aradhat diverzante t'Armates Demokratike kane hjedhe n'ajr nji park te magazave.

Konferenca nderkombtare e Rinis punuese ne Varshave muer fund

Ne konferencen nderkombetare te rinis ne Varshave, ku u-shqyrtuen çashtjet me randesi kohnale per rinin punuese te sotme botes dhe ku u-murren vendimet konkrete mbi luften e mateshme per realizimin e kerkesave politike dhe ekonomike te gjeneracjonit te ri, muerr pjese edhe delegacjoni i rinis punuese te Jugoslavis.

Delegacjoni i rinis se Jugoslavis, qe perbahej nga 10 delegate — perfaqsuesit e rinis punuese nga te gjitha viset e Vendit t'one — dhe nga pese shqiptare, i paraqiti konferences referatin mbi pozitien e rinis punuese ne Vendin t'one per sa i perket çashtjes se luftes per sypriminin e punes se femijve, zhvillimin e legjislatures sociale dhe te mprojtjes shendetsore te rinis dhe ka marre pjese ne punen e komisjoneve, te cilat e kane pregadite rezolucjonin e konferences.

Ne mbarim te konferences e mbasi u-kthye ne Beograd, delegacjoni ka paraqitë raportin sekretarjatit te kuvendit qendror te rinis popullore te Jugoslavis, i cili ne tanesi e aprovoi punen e delegacjonit ne konferenc.

Tue marre parasysh randesin e madhe te vendimeve te marruna ne konferencen e Varshaves si per luften e pergjithshme te rinis demokratike te botes per paqe, pamvarsi kombetare dhe te drejta te gjeneratës se re, ashtu edhe per punen e ardhshme dhe zhvillimin e levizjes botnore te rinis, sekretarjati i kuvendit qendror te rinis popullore te Jugoslavis ka prue konkluzen konkrete mbi njoftjen ma te gjane te rinis se Jugoslavis me punet dhe vendimet e konferences.

Anglo-Amerikanet po e krijojne qendren e spijunazhit kundra vendeve te demokracis popullore

Prage:

Fletorja "Lidova Demokracie", tue u-bazue ne lajmet nga qarqet e informueme mire, shkruen se "Intelligence Servis" Britanik i ka njoftue organet informative te vendeve te paktit te Brukselit se Shtetet e Bashkueme t'Amerikes po e krijojne n'Europe nji qender speciale, e cila duhet t'i plotesoje funksjonet qe i ka kryejte luftes e ashtuquejtuna byro e informatave strategjike.

Kjo, byroja, ka organizue sabotime, akte teroriste dhe diverzive. Qendra e re do t'organizoje veprimtarin subversive ne vendet e demokracis popullore. Ajo ka per qellim me i zhdukë funksjonaret e shquem politik dhe shtetnuer te frymezuem me ndjenja anti-amerikane n'Europe.

Qendra e kesaj byroje te re do te jete ne Zvicer, e filjalat e saja ne Berlin dhe n'Istambull. Udheheqesi i qendres kryesore do te jete ish kryetari i filjales se byros s'informatave strategjike ne Zvicer-Alen Dalls. Ne Berlin dhe n'Istambull byrole do t'udhehiqen nga Donoven Heiller dhe Lemboren.

Suksese t'Armates Demokratike greke

ATHINE:

Radjo stacjoni i Greqis se lire n'emisjonin e dates 23 te k.m. transmeton lajmin e shtabit kryesuer t'Armates Demokratike mbi operacjonet ne Pindin e verit. Ne komunikaten ne fjale thuhet se ne periudhen 14 qershuer deri me 21 gusht te k.v. njisite e Armates Demokratike jo vetem qe e kane [illegible] kryesore t'usntrts monarko-fashiste ne sektorin Boiom-Smolikas Gramos, por dhe kane ba kundrasulme dhe i kane shkaktue armikut humbje te randa. Ne ket periudhe ushtrija monarko-fashiste ka pesue keto humbje: 5125 oficera dhe ushtare te vdekun, 16.000 te plagosun, 439 te zanun robe, 1298 kane dezertue. Ne te njajten periudhe mprojtja kundraajrore e Armates Demokratike ka rrxue ne Pindin e verit 25 aeroplana, dhe jane vra e plagose ma se 50 pilota t'armikut. Jane asgjasue 18 tanksa dhe 5 topa, si dhe jane zane rezerva te mdhaja te materjalit luftarak.

Ne sektoret prendimore te Berlinit durojne uni ma se 100.000 puntore

Korespondenti i „Tanjugut" njofton nga Berlini se simbas komunikates se komandes sovjetike te Berlinit, ne sektoret prendimore te qytetit numri i te pa-punve asht shtue ne 50.000 veta e numri i te lypcave qe pune pjeserisht kapet ne 60.000 veta. Ne kete menyre, ne sektoret prendimore durojne uni ma se 100.000 puntore bashke me familjet e tyne. Tue u-perpjeke qe t'a ashpersoje edhe ma krizen ne Berlin, drejtorija e qytetit ka refuzue oferten e komandes sovjetike mbi dhanjen e qymyrit si dhe landeve te tjera te para e ndihmen ne te holla per sektoret prendimore te Berlinit.

Tue marre mbi vedi kujdesimin mbi mbare popullsin e Berlinit, komanda sovjetike i merr te gjitha masat per me i shtie ne pune te gjithe te papunet nga sektoret prendimore ne sektorin sovjetik te qytetit, keshtu qe ne javet e fundit mija puntore kane hyne ne pune perseri. Simbas komunikates se botueme, ne sektorin sovjetik mund te hyejne ne pune edhe 25.000 puntore te degve te ndryshme. Ne komunikate vehet ne dukje se komanda sovjetike asht gadi me iu gjete pune puntorve te sektorve prendimore dhe simbas deshirave te tyne ne qytetet Lajpcig, Dresden, Merzenburg dhe qendra te tjera industrijale te zones sovjetike.

Lufta çlirimtare e popullit te Burmes

Njisite e korparmates popullore vullnetare te Burmes kane arrijte afer Rangunit.

Mbas suksesave qe patien para disa dive njisite korparmates popullore vullnetare te Burmes i jane afrue kryeqytetit te Burmes, Rangun, ne te cilin asht ba shtetrrethimi, qeverija e Burmes ka qene e detyrueme te marre masa te veçanta me qellim qe t'a ndaloje perhapjen e kryengritjes kundra qeveris te Tokin Nun.

Agjensija „Junajted Pres" lajmeron se kryetari i republikes se Burmes Shau She Tajke ka deklarue vuejtjen ne zabtim te shtetrrethimit ne te gjitha qarqet e Burmes, te cilat i kontrollojne kryengritsat. Per me e frigue popullsin e [illegible] i milijonave kryengritsat, qeverija i ka ba nji thirrje popullsis t'atyne viseve ku jane kryengritsit qe te largohet nga ato vise, sepse do te bombardohen nga njisite ajrore te qeveris.

Nga nji tjeter lajm i agjencis „Junajted Pres" shihet se kryengritsat e kane marre qytetin Tajetmio, qender me randesi industrijale ne lumin Iravadi. Luftime te rrebta zhvillohen gadi qe nji jave ne qytetin Strijama, tre milja ne jug te Rangunit, ku ndodhen instalimet e „Burma oil kumpani".

Botimi i Keshillit Krahinuer te Frontit popullor—Sipermarrja per shtyp dhe botime "Milladin Popoviq„ Prishtine.
Pajimet ne fletoren i pranon: Administrata dhe ekspedicioni. Numri i çekut 906030.